

**SERVIZIO SANITARIO REGIONALE  
EMILIA-ROMAGNA**  
Azienda Unità Sanitaria Locale di Reggio Emilia  
IRCCS Istituto in tecnologie avanzate e modelli assistenziali in oncologia

## **SI TË ARRIJMË KONTROLLIN E SFINKTERIT**

**RAGGIUNGERE IL CONTROLLO SFINTERICO**

**Sugjerime dhe këshilla për anëtarët e familjes  
së fëmijëve me çrregullime neuro-zhvillimore,  
veçanërisht me çrregullime të spektrit të  
autizmit**



Kjo broshurë është realizuar për tezën e kërkimeve të Ilaria Lalinga, që po diplomohet në Teknikën e Rehabilitimit Psikiatrik, në Universitetin e Studimeve Modena dhe Reggio Emilia, ka lindur nga projekti i Viani Federica, *Teknike Rehabilitimi Psikiatrik e Qendrës së Autizmit Reggio Emilia*, hartuar nën mbikëqyrjen e Dokt.sha Virginia Giuberti, *Psikologe dhe Psikoterapiste, Drejtuese e Qendrës së Autizmit Reggio Emilia* dhe me bashkëpunimin e Dokt. Gino Montagna e Dokt.sha Francesca Bontempo, *Pediatër të familjes tek Ausl Reggio Emilia*.

Imazhet në broshurë dhe në skedarët e bashkëlidhur në internet janë marrë nga portali aragonez i komunikimit shtues alternativ (CAA) <https://www.arasaac.org>

Autor i piktogrameve: Sergio Palao

Origjina: ARASAAC (<http://arasaac.org>)

Licencat: CC (BY-NC-SA)

Pronësia: Qeveria e Aragonës

*Shkurt 2020*

## HYRJE

Si Qendër Autizmi, ne na duhet të japim informacione dhe përgjigje për shumë pyetje dhe dyshime të prindërve në lidhje me aftësinë për kontrollin e sfinkterit (aftësinë për të përdorur WC-në) nga ana e fëmijëve të tyre.

Kjo broshurë është krijuar pikërisht duke pasur si synim që të jetë një mbështetje dhe ndihmë më e madhe, duke propozuar një sërë teknikash dhe sugjerimesh në lidhje me aftësinë për kontrollin e sfinkterit.



Por nuk duhet harruar se, përtej strategjive dhe teknikave, çdo fëmijë është unik dhe një metodë efikase për një fëmijë, mund të mos jetë efikase për një tjetër. Gjithashtu në literaturën shkencore përshkruhen procedurat e “**Toilet Training**” (stërvitje tualeti) ose “**heqje pelenash**” që janë të ngjashme, por jo e njëjta gjë.

Është thelbësore që të krijoni një **itinerar të individualizuar** për fëmijën tuaj dhe ju këshillojmë që të diskutoni, përpara se të filloni, me ekipin e specialistëve që është duke e ndjekur (neuropsikiatër ose psikolog, terapistë, pediatër), si dhe me mësuesit që janë në gjendje ta vëzhgojnë atë gjatë rutinës së jetës së përditshme të jetës parashkollore (kopshtit). Autonomitë nuk janë aftësi të lindura por fitohen gradualisht nëpërmjet **mësimdhënies dhe ndihmave që jepen nga të rriturit referues**, pra le të armatosemi të gjithë së bashku me **durim dhe këmbëngulje**. Kontrolli i sfinkterit fitohet, afërsisht, ndërmjet 18 muajve dhe tre vjetëve të jetës, por ekziston një **ndryshueshmëri individuale**: disa fëmijë janë më të hershëm, të tjerëve u nevojitet më shumë kohë.

Në faqen e internetit të Ndërmarrjes sanitare Azienda Usl di Reggio Emilia në lidhjen e mëposhtme, mund të konsultoni, shkarkoni dhe të shtypni materiale shtesë: <https://www.ausl.re.it/programma-autismo-e-disturbi-dello-spettro-autistico-asd->

- **Aneksi 1.** Version i zgjeruar i kësaj broshure (i plotë dhe që përmban udhëzime më të hollësishme)
- **Aneksi 2.** Tabela për skemën e evakuimit
- **Aneksi 3.** Imazhe (për kalimin në banjë, sekuencat vizive, çmimet, etj.)
- **Aneksi 4.** Bibliografia
- **Aneksi 5.** Libra të ilustruar për fëmijë në lidhje me këtë argument

## KËSHILLA PRAKTIKE

### Këshillohet të procedojmë në mënyrë graduale

këshillohet të fillojmë adoptimin e strategjisë së “heqjes së pelenave” në **stinën pranverore**, në mënyrë që “të kufizojmë dëmet”: “aksidentet” që mund të verifikohen do të jenë më të durueshëm sesa në dimër (*p.sh. më pak ndërresa që lagen ose që ndoten dhe që lagen e thahen më shpejt*) dhe gjithashtu për të pasur një kohë më të gjatë para nesh për të mësuar dhe për të eksperimentuar (*pranverën dhe verën*).



Në fillim do të punojmë vetëm për të mësuar **kontrollin sfinkterik ditor** (*gjatë orëve kur fëmija juaj është zgjuar*), vetëm më vonë do të arrijmë edhe atë të **natës**, ose sidoqoftë gjatë orëve të gjumit (*gjumit të pasdites e të natës*).

**Objekti ynë fillestar do të jetë vetëm që t'i mësojmë aftësinë për bërë ujin e trashë dhe të hollin në klozet**, prandaj ka mundësi që i rrituri të duhet të bëjë të gjithë hapat e mbetur në vend të fëmijës.

Në fakt duhet të keni parasysh se aftësia për të shkuar në banjë në autonomi të plotë përbëhet nga disa aftësi të marra së bashku (*p.sh. njohja e nevojës për të shkuar në banjë, komunikimi i nevojës, pritja përpara evakuimit/urinimit, hyrja në banjë, ulja e pantallonave, etj.*). Edhe fakti, për shembull, që fëmija të sinjalizojë nevojën për të shkuar në banjë do të jetë gjithashtu një objektivi që mund ta ndjekim në një kohë të mëvonshme. Në fakt, në fillim të itinerarit, duhet të jeni ju prindërit ata që do t'i propozoni fëmijës suaj të shkojë në banjë sipas orarit të caktuar, vetëm më pas fëmija do ta bëjë të qartë nevojën e tij dhe do t'ju kërkojë ta shoqëroni në banjë.




Tani do të përballemi së bashku, në mënyrë të përmbledhur, me **hapat e itinerarit** që mund të vendosni për të mësuar fëmijën tuaj të fitojë kontrollin e sfinkterit dhe autonominë në banjë.

Sugjerimet më pas do të personalizohen për fëmijën tuaj.

## Hapi i parë |

### VLERËSOJMË RITMET FIZIOLOGJIKE TË FËMIJËS

Para së gjithash, është e rëndësishme të përcaktoni **skemën e evakuimit** të fëmijës suaj, pra të përpiqeni të kuptoni nëse ai ka ritme fiziologjike pak a shumë të rregullta, duke përcaktuar orët kur ka më shumë mundësi të urinojë ose të bëjë ujin e trashë.



Pra, **për dy javët e para, vazhdojmë të përdorim pelenën** (për ta zëvendësuar me një pelenë në formë mbathjesh, shumë më praktike) dhe përafërsisht një herë në çdo orë, e çojmë në banjë për të kontrolluar nëse fëmija është i lagur, i ndyrë ose i pastër. Për mbledhjen e informacioneve mund të jetë e dobishme të shtypni dhe të plotësoni **tabelën** që gjendet në faqen e internetit të Qendrës së Autizmit.

✓	LU	MA	MI	JU	VI	SA	DO

Gjithashtu le të përpiqemi t'i propozojmë, pa e detyruar, që **të ulet për pak minuta mbi klozet** dhe ta ndërrojmë pelenën vetëm nëse është e lagur ose e ndotur.

Kjo fazë mund të zgjasë edhe më shumë se dy javë, duhet të bëjmë një vlerësim herë pas here në bazë të kërkesave të familjes dhe të fëmijës.

## Hapi i dytë |

### PËRCAKTOJMË ORARIN KUR DUHET TË SHKOJË NË BANJË

Pas kësaj periudhe dyjavore, do të duhet të shohim tabelën, kështu që vazhdojmë si në vijim:

#### 1. Vlerësoni nëse fëmija juaj është i gatshëm të vazhdojë me ushtrimet, duke marrë parasysh kërkesat e mëposhtme:

- **Është i thatë** në intervale të paktën prej një ore e gjysmë.
- **Tregon** ndonjë shenjë që është i vetëdijshëm se është i lagur ose i ndotur, ose ndalet gjatë kohës që po laget ose ndotet.
- **Pranon që të jetë** i shoqëruar për në banjë.
- **Pranon të rrijë** i ulur mbi klozet për të paktën 5 minuta, duke filluar nga 1 minutë dhe më pas duke e shtuar dalëngadalë.

Periudha e nevojshme për të arritur këto kërkesa mund të jetë më e gjatë se dy javë; për të ndihmuar fëmijën tuaj mund të gjeni udhëzime dhe sugjerime në broshurën e plotë të disponueshme në faqen e internetit të faqja e Qendrës së Autizmit.

## 2. Vlerësoni se me cilën aftësi dëshironi të filloni: ta mësoni fillimisht të urinojë apo të evakuojë?

Vendimi për të filluar ushtrimin me ujin e trashë në klozet ose me ujin e hollë është subjektiv dhe ndryshon nga fëmija në fëmijë.

Sidoqoftë, mund të konsiderojmë se bërja e ujit të hollë është më e shpeshtë dhe më pak e parashikueshme se bërja e ujit të trashë.

Prandaj, nëse fëmija juaj e bën ujin e trashë rregullisht, do të duhet të shfrytëzojmë rastin dhe ta mësojmë duke filluar ta çojmë mbi klozet në orët kur ai zakonisht del jashtë, sepse do të kemi më shumë mundësi për të pasur sukses, duke përballuar një angazhim më pak të rëndë, sepse:

- **ndodh** më rrallë dhe në mënyrë më sistematike në krahasim me ujin e hollë;
- **është më kollaj** të kuptojmë sinjalet (*p.sh. sforcohet, mbliidhet kruspull - ulet galiç skuqet në fytyrë...*);
- **ka më shumë mundësi** që të dalë jashtë çdo herë që shkon në banjë.

Kur të ketë mësuar ta bëjë ujin e trashë në klozet në vend të pelenës, do të jetë më e lehtë të kalojë në bërjen e ujit të hollë sepse fëmija tashmë do të ketë pak më shumë familjaritet me shkuarjen në banjë.

Nëse, përkundrazi, fëmija juaj nuk ka ritme të rregullta, vlerësoni se nga ku duhet të filloni në bazë të njohjes së zakoneve të tij (*p.sh. nëse jashtëqitja është një moment delikat për të, ka zakone të sakta dhe fikse dhe për këtë arsye rrezikohet që ta nervozoni menjëherë, më mirë atëherë të mos fillojmë fare nga kjo aftësi*).

## 3. Përcaktojmë orarin kur duhet të shkojë banjë.

Të dhënat që kemi mbledhur në dy javët përpara fillimit të "*heqjes së pelenave*" do të na ndihmojnë të përcaktojmë orët kur fëmija ka më shumë të ngjarë të ketë nevojën fiziologjike për të shkuar në banjë dhe gjithashtu intervalin e tij të kontinencës, ose pjesën e kohës ndërmjet një urinimi dhe të një tjetri.



Në bazë të këtyre të dhënave, do të duhet të vendosim orarin orientues për ta çuar në banjë, duke u përpjekur të parashikojmë pak orarin tij fiziologjik, për të parandaluar aksidentet.

Në tabela, orari me numrin më të lartë të K-ve (*C, kakë*) ose U-ve (*P, urinë*) gjatë dy javëve korrespondojnë me skemën e evakuimit të fëmijës suaj.

- **Uji i trashë:**

- ✓ *nëse skema e fëmijës suaj është e rregullt:* do të duhet ta çoni në banjë pesëmbëdhjetë minuta përpara orës kur ai zakonisht bën nevojën;
- ✓ *nëse fëmija juaj nuk ka një skemë të rregullt:* do të duhet ta çoni në banjë 15 minuta përpara orës së parë në të cilën është shënuar një K (*kakë në pelena*), pastaj duhet të vazhdoni të përqipeni ta çoni çdo dy orë, derisa të evakuojë.

- **Uji i hollë:**

orët e caktuara të urinimit do të jenë më shumë, kështu që do të zgjedhim nga 4 deri në 8 orë të caktuara në ditë në të cilat ka më shumë të ngjarë të urinojë, në bazë të asaj që shkruhet në tabelë, ose duhet ta çojmë sipas një orari të rregullt duke u bazuar në intervalin e tij të kontinencës (*p.sh. nëse ai urinon çdo dy orë, ne do ta çojmë në banjë çdo herë, rregullisht, pak para se të kalojnë dy orët*).

## Hapi i tretë | PËRGATITIM AMBIENTIN

Përpara se të fillojmë ta çojmë fëmijën në banjë duke ndjekur tabelën e orarit që kemi përcaktuar, këshillohet që të përgatisim ambientin dhe rutinën për të rritur mundësitë tona për të pasur sukses.



- **Duhet të jeni konstant dhe të parashikueshëm:** kur fillojmë, është e nevojshme të vazhdojmë rutinën e banjës çdo ditë, në mënyrë pothuajse të pandryshuar.



- **Përfshini të gjitha figurat** që sillen afër fëmijës suaj (*gjyshërit, të afërmit e tjerë, mësuesit, edukatorët, etj.*) duke ndarë modalitetet për ta çuar në banjë dhe duke i dhënë të gjithëve ndërrimin e rrobave në rast “aksidentesh” në mënyrë që ata ta ndërrojnë atë.

- **Kryeni të gjitha veprimet brenda në banjë** (p.sh. heqjen e pelenës, uljen në klozet, ndërrimin e rrobave të lagura ose të ndotura, etj.), kjo e ndihmon fëmijën ta shoqërojë këtë seri sjelljesh me një vend të veçantë (*banjën*).



- **Zvogëloni shpërqendrimet:** këshillohet të eliminoni nga banja çdo burim shpërqendrimi: lodra ose objekte që mund ta tërheqin dhe ta shpërqendrojnë nga objektivi (*nëse keni më shumë se një banjë në shtëpi, zgjidhni se cilën do të përdorni duke preferuar atë që është më shumë "e zhveshur", pra atë që është me më pak objekte të lidhura me aktivitetet e tjera*).



- **Përdorni klozetin normal** qysh në fillim, duke vendosur mbi të një **reduktor** për ta bërë ndenjen më të rehatshme dhe të qëndrueshme. Zgjidhni një reduktor shumëngjyrësh, me personazhet e preferuar, ose sido që të jetë, por joshës. Mund të vendosni një **mbështetëse për ta lejuar që të hipë dhe të mbështesë këmbët** (*mbështetësja është gjithashtu e dobishme sepse pozicioni me mbështetjen e këmbëve dhe shalët e përkulura në 90° në lartësinë e gjurit lehtësojnë shtytjen për nxjerrjen jashtë të feçeve*). Nëse preferoni të përdorni një oturak, mbajeni atë në banjë dhe përdoreni gjithmonë atje.



- **Vlerësoni, në rastin e një fëmije mashkull, nëse doni t'i mësoni të urinojë ulur ose në këmbë:** sidomos në fillim, do të ishte më mirë ulur për dy arsye: shmanget hapi i detyrës për të "*mbajtur*" penisin dhe, përveç kësaj, ndërsa është i ulur, mund të ketë edhe ndonjë stimul të mundshëm evakuimi. Për cilindo pozicion të keni preferencë, është e rëndësishme që, të gjithë të rriturit që kujdesen për fëmijën tuaj, të jenë të informuar dhe të veprojnë në të njëjtën mënyrë.





- **Jepini fëmijës të pijë shumë lëngje** (*ujë ose pije të tjera që i pëlqejnë*): stimulimi i pirjes së lëngjeve nxit si diurezën ashtu edhe evakuimin, është i dobishëm në përgjithësi, por veçanërisht me fëmijët që "*e mbajnë*" në mënyrë që të mos ta lëshojnë brenda në klozet.





- **Zëvendësoni pelenën me mbathjen normale në mënyrë të vazhdueshme:** do të ishte më mirë që të mos e ngatërrojmë fëmijën duke ia vënë dhe duke ia hequr pelenën gjatë gjithë ditës në varësi të situatave ose të nevojave. Mesazhi më i qartë për fëmijën është të *shoqërojë pelenën me momentin e gjumit dhe mbathjet me zgjimin.*



Për të administruar më mirë udhëtimet me makinë, mund të pajisemi me traversa njëpërdorimshme për t'i mbështetur në ndenjësën e fëmijëve; ndërsa kur dilni jashtë, merrni gjithmonë me vete disa ndërresa dhe sapo të arrini në ndonjë vend, gjeni banjën dhe shoqëroni fëmijën në intervalet e paracaktuara për të qenë vazhdimisht të stërvitur.

- **Afrojeni fëmijën në rutinën e banjës në një mënyrë “transversale”:** mund t'i propozoni fëmijës suaj, gjatë momenteve të lojës, skena zbavitëse në të cilat kukulla e preferuar, një dordolec, një personazh, bën shumë gjëra dhe, ndër të tjera, shkon edhe në banjë.



Ose mund të shikoni së bashku libra të ilustruar për fëmijë, video ose filma të vizatuar, ose histori shoqërore të krijuara posaçërisht, që trajtojnë temën specifike të përdorimit të banjës.


- **Përdorni një objekt tranzicioni për në banjë ose një mjet ndihmës viziv (imazh):** mund të rezultojë e dobishme t'i jepet në dorë, për ta marrë me vete në banjë, një objekt tranzicioni që lidhet me shkuarjen në banjë ose një fotografi e banjës. Kjo shërben për të ndihmuar fëmijën që të kuptojë se ku po shkojmë dhe çfarë do të ndodhë. Imazhi mund të përdoret më vonë, nëse fëmija juaj ende nuk flet, për t'i komunikuar të rriturit nevojën për të shkuar në banjë.



- **Përgatisni ndihmat vizive dhe vendosni një rutinë me ndihmën e imazheve:** brenda banjës, këshillohet të ekspozoni një sekuençë vizive të imazheve (*fotografike ose simbolike*) në rutinën e shkuarjes në banjë: kjo na lejon t'i komunikojmë fëmijës të gjitha informacionet e dobishme (*duke kapërcyer në disa raste edhe vështirësitë eventuale të të kuptuarit dhe të shpjegimeve vetëm nëpërmjet gjuhës verbale*) dhe i jep mundësinë atij të njohë dhe të jetë i qartë për atë që do të ndodhë dhe çfarë hapash duhen bërë. Në fund të imazheve të sekuençës, ne mund të fusim edhe imazhin e shpërblimit që do të marrë.



- **Mësoni të njihni sinjalet e fëmijës suaj:** është e dobishme të mësoni të njihni sinjalet që çdo fëmijë, edhe në mënyrë të pavullnetshme, lëshon para se të evakujë ose të urinojë (*p.sh. ai bëhet i kuq në fytyrë, përkulet mbi këmbët e tij, qëndron i heshtur, shkon tek një qoshe, etj.*) dhe porsa të vërehen, çojeni në banjë edhe nëse orari nuk bën pjesë në prospektin që kishim krijuar.



- **Përdorimi i shpërblimeve:** kryesisht në fazën fillestare, përdorni shpërblime të vogla, duke i shoqëruar me lavdërime dhe komplimente, të cilat do ta bëjnë fëmijën tuaj më të motivuar për të përdorur banjën; kjo gjë do ta përshpejtojë dhe do ta bëjë mësimin më të këndshëm. Në një kohë të dytë, kur ai të jetë aftësuar, gradualisht do t'i zvogëlojmë dhe pastaj do t'i eliminojmë, pasi nuk do të nevojiten më.

Shpërblimi duhet të jetë *diçka që fëmija e dëshiron shumë*, por kur fillon ushtrimi, ai përdoret *ekskluzivisht në banjë për të shpërblyer angazhimin e tij.*



Është e rëndësishme që fëmija të mos shpërblehet në kohë të tjera të ditës ose në ambiente të tjera.

Merrni parasysh nëse do të përdorni një ushqim të lehtë (*p.sh. patate të fërguara, karamеле, bonbone...*) që ka avantazhin e konsumimit të menjëhershëm dhe për këtë arsye nuk ia tërheq vëmendjen fëmijës, ose një aktivitet apo një lodër në bazë të preferencave të fëmijës.

## Hapi i katërt |

# KRIJOJMË RUTINËN E SHKUARJES NË BANJË

Tani do të fillojmë ushtrimet e mirëfillta të mësimdhënies, duke e shoqëruar fëmijën në banjë në orë të caktuara të rregullta, duke zëvendësuar pelenën me mbathje (*gjatë ditës*) dhe duke krijuar rutinën e shkuarjes në banjë.

- **Çojeni në banjë** në orën e caktuar ose kur jep ndonjë shenjë se ka nevojë. Ulni pantallonat poshtë gjunjëve (*në qoftë se ai mund ta bëjë vetë këtë veprim, ose të paktën pjesërisht, duhet ta inkurajojmë t'i ulë vetë*) dhe ta ftojme të ulet mbi klozet.



Krijoni mundësinë që të **rrijë i ulur aty për të paktën 5 minuta**, qëndroni me të dhe pritni.

Herë pas here bëni komplimente, duke e lavdëruar që ka ndenjur i ulur. (P.sh. "Bravo! Je ulur mbi klozet!") dhe shpjegoji se çfarë duhet të bëjë në mënyrë direkte, por jo kërkuese, pa i dhënë urdhra.

- **Nëse evakuon ose urinon**, bëni komplimente në mënyrë të gëzueshme dhe jepini menjëherë shpërblimin. Menjëherë pas kësaj, pastrojeni dhe dilni nga banja.
- **Nëse nuk evakuon ose urinon pas 5 minutash**, ndihmojeni të zbresë nga klozeti dhe dilni nga banja sipas orarit tjetër që keni hipotizuar, ose kur jep shenja se duhet të ktheheni përsëri në banjë.
- **Nëse do të verifikohet ndonjë "aksident"**, me fjalë të tjera, fëmijës i shpëton kaka ose urina në mbathje, mos e qortoni, por gjithsesi çojeni në banjë, hiqini rrobat e ndotura, tregojani klozetin dhe përsëritni këshillën verbale dhe gjestuale "*kakën/urinën në banjë*". Gjithashtu, në rastin e ujit të trashë (kakës), mund të jetë e nevojshme të "zbrazni" të mbathjet e ndotura brenda në klozet.

Në fillim do të jetë një situatë e pakëndshme për të rriturin pasi mund të ketë shumë "*aksidente*", por bëhet fjalë për një hap të nevojshëm dhe normal meqenëse fëmija juaj ishte mësuar ta lëshonte në pelenë.

*Është shumë e rëndësishme që të mos e qortoni dhe të mos e bëni të ndihet fajtor nëse, në fillim, nuk arrin të përdorë klozetin.*

## Hapi i pestë |

### T'I MËSOJMË TË JETË

#### KREJTËSISHT I PAVARUR NË BANJË

Kur fëmija juaj të ketë mësuar më në fund të përmbahet para se të evakuojë dhe të urinojë dhe të kryejë nevojat e tij në banjë (aftësi për të shkuar në banjë) mund t'i mësojmë atij të gjitha aftësitë e tjera që do t'i japin mundësi të jetë plotësisht i pavarur në sekuencën e plotë të veprimeve që përbëjnë shkuarjen në banjë (*aftësinë e pavarësisë për të shkuar në banjë*) siç janë, për shembull, **ulja dhe ngritja e pantallonave dhe mbathjeve, përdorimi korrekt i letërsh higjienike, shkarkimi i ujit të klozetit, qëndrimi vetëm në banjë e shkuarja vetëm në banjë duke ndjekur këshillat e të rriturit.**

Do të duhet t'i kushtoni vëmendje të veçantë **aftësisë për të komunikuar nevojën për të shkuar në banjë**, pavarësisht nëse fëmija juaj përdor gjuhën verbale ose nuk e përdor atë. Në këtë rast do të duhet ta mësoni të përdorë instrumentin e komunikimit shtesë alternativ (AAC) që fëmija tashmë e njihet (*imazhe ose shenja*). Mund të konsultoheni me faqen tonë në internet për të marrë të gjitha informacionet në lidhje me udhëzimet për të mësuar këto aftësi. Objektivi ynë përfundimtar duhet të jetë gjithmonë që të **favorizojë autonominë e plotë të fëmijës suaj, duke zvogëluar gradualisht nxitjet ose ndihmat nga i rrituri.**




Fëmija juaj mund t'i ketë mësuar shumë mirë këto hapa individualë pa qenë në gjendje, megjithatë, t'i kryejë pa ndonjë ndihmë të vogël nga i rrituri, ose pa inkurajime të vazhdueshme apo duke mos qenë në gjendje t'i përfundojë në mënyrë të vazhdueshme e të njëpasnjëshme.

- **Çfarë duhet të bëni nëse fëmija juaj "harron ose kapërcen" ndonjë hap të sekuencës:** nëse vini re se shërben ndonjë ndihmë, jepni ndihmë fizike (me fjalë të tjera qëndroni pas shpatullave të tij dhe drejtojeni atë në hapin tjetër), ose tregojini hapin në sekuencën vizive të imazheve, ose, nëse fëmija flet dhe është në gjendje të përgjigjet, provoni ta pyesni: "çfarë duhet të bësh?" në vend që t'ia sugjeroni atë drejtpërdrejt.

## SUGJERIME SE SI TË ZGJIDHIM PROBLEMET SPECIFIKE

Gjatë rrugëtimit të përvetësimit të aftësisë për të shkuar në banjë, mund të hasim vështirësi në ndonjë fazë. Në këtë rast është thelbësore, para së gjithash, të përpiqeni të mendoni se cili mund të jetë këndvështrimi i fëmijës suaj: *pse nuk bën një gjë të caktuar të cilën po ia kërkojmë ta bëjë? Pse nuk po përgjigjet siç do të prisnim të përgjigjej?*




Kur të kemi hipotezuar ose kuptuar "pse", do të duhet të mendojmë se si mund të zgjidhim vështirësinë që është shfaqur, duke ndihmuar fëmijën me strategji ose duke thjeshtuar/sqaruar me ndonjë mjet eventual viziv për të rritur mirëkuptimin, bashkëpunimin dhe motivimin.

Online në faqen e internetit të Ndërmarrjes Usl do të gjeni strategji dhe këshilla që mund të jenë të dobishme në rast se do të jeni të detyruar të përballoni **vështirësitë e mëposhtme:**

- *Kundërshton që të ulet mbi klozet.*
- *Nuk rri i ulur për një kohë të mjaftueshme.*
- *E mban kur i hiqet pelena ose nuk e ka kuptuar se si ta lëshojë urinën.*
- *Çdoherë që është mbi klozet nuk nxjerr jashtë asgjë.*
- *Ndodhin "aksidente" të shpeshta në të cilat ai bën ujin e hollë në rroba ose ujin e trashë, jashtë orarit në të cilin kishim menduar ta çonim në banjë.*
- *Shpreh frikë për të tërhequr ujin e shkarkimit të klozetit.*
- *Interesi i tepërt për shkarkimin e ujit e habit atë dhe nuk ulet mbi klozet (wc).*
- *Luan me letrën higjienike.*
- *Nuk dëshiron të jetë i pastër.*
- *Nuk dëshiron të veshë mbathjet, kërkon pelenën.*

## PËRGJIGJET E PEDIATËRVE PËR PYETJET DHE SHQETËSIMET TUAJA

Pjesa më e madhe prindërve gjatë rrugëtimit për të mësuar fëmijën e tyre të përdorë siç duhet tualetin, pushtohen nga dyshime dhe pyetje. Për t'ju dhënë përgjigje dhe informacione të plota, gjithëpërfshirëse dhe të bazuara në prova mjekësore, janë përfshirë në hartimin e kësaj broshure edhe Pediatrit e familjes së Ausl Reggio Emilia.




Ndërmjet materialeve të disponueshëm në faqen e internetit të Ndërmarrjes Usl, do të gjeni përgjigjet e pediatërve për pyetjet që bëhen më shpesh në lidhje me këtë argument:

- *Sipas nivelit fiziologjik, si rregullohet mekanizmi i ujit të hollë?*
- *Sa shpesh duhet ta bëjë ujin e hollë? Ndonjëherë ai nuk e bën atë për disa orë!*
- *Nganjëherë e mban ujin e hollë për një kohë të gjatë, madje edhe për disa orë të tëra ose një ditë të tërë! Kam frikë se nëse e mban urinën për një kohë të gjatë, atëherë do t'i shpërthejë fshikëza e urinës ose gjithsesi do të ketë dëmtime serioze! Ose do të dehidratohet!*
- *Kam frikë se nëse i mban feçet për shumë kohë, atëherë do të ketë dëmtime serioze!*
- *Gjatë dy javëve të vlerësimit, e kam gjetur gjithnjë pelenën të lagur... çfarë do të thotë kjo?*

**Ju kujtojmë se bëhet fjalë për informacione në vija të trasha; për t'u thelluar më shumë rreth fëmijës suaj, ju këshillojmë që të drejtoheni te pediatri i familjes.**





**SERVIZIO SANITARIO REGIONALE  
EMILIA-ROMAGNA**

**Azienda Unità Sanitaria Locale di Reggio Emilia**

**IRCCS Istituto in tecnologie avanzate e modelli assistenziali in ortologia**